EMRAT/ Nuk ndaloi automjetin me të cilin shpërndante kokainë, arrestohet 30-vjeçari në Peqin, e pësON edhe babai i tij

04 Mars, 2025 11:20



Madhësia e tekstit:

Një 30-vjeçar, i identifikuar si Ervis Sula, është arrestuar nga policia, pasi nuk ndaloi automjetin me të cilin shpërndante lëndë narkotike.

Blutë njoftojnë se 30-vjeçari tentoi të largohej me shpejtësi, duke iu rrezikuar jetën punonjësve të Policisë.

Ndërkohë ka nisur procedim penal edhe për babanë e 30-vjeçarit.

Në kontrollet e kryera në banesë, u gjetën: 630 gramë Cannabis, një sasi Kokaine, 3 armë gjahu, 2 armë të ftohta (thika), 1 armë sportive, 55 fishekë, sasi baruti me të cilin mbusheshin fishekët, 1 palë dylbi dhe 1 dedektor metal-kërkues.

Njoftimi i policisë:

Në vijim të aksioneve policore kundër veprimtarive kriminale në fushat e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje, shërbimet e Sektorit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale dhe me shërbimet e Komisariatit të Policisë Peqin, finalizuan operacionin e koduar "Risku".

Në kuadër të operacionit u vu në pranga shtetasi Ervis Sula, 30 vjeç dhe u procedua në gjendje të lirë, babai i tij, shtetasi F. S., 67 vjeç, të dy banues në Peqin.

Në bazë të informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore, në lagjen "Teqe", i është bërë shenjë ndalimi, automjetit me drejtues shtetasin E. S., i cili dyshohej se shiste Kokainë dhe Cannabis, në Peqin. 30-vjeçari nuk i është bindur urdhrit për ndalim, por ka vijuar lëvizjen me shpejtësi, duke rrezikuar jetën e punonjësve të Policisë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Operacioni me efektivë të arrestuar! Hajdarmataj: Grupet kriminale mos të emërojnë shefat e komisariateve
04 Mars, 2025

Policët bashkëpunonin me elementë kriminalë! Saraçi: Goditja e veprimtarisë të paligjshme u bë vonë. Mund të jemi në kohën e trafikut të kokainës
04 Mars, 2025

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Përgjimi nga SPAK i anëtarit të Kushtetuesës! Avokati Sefa: Ka dyshime se në GJK ka pasur tentativë nga grupet kriminale...
04 Mars, 2025

Gjendet pa shenja jete 41-vjeçari në Vlorë, policia: Dyshohet se vuante nga probleme shëndetësore
04 Mars, 2025

Përplasja në GJKKO/ Nuredin Dumani akuza Agron Qolit: Pasi e vratë Fatmira Dedën i shkove në varrim. Ke paguar edhe shpenzimet e mortit!
04 Mars, 2025

"Ti je i ndyrë, për ca topa letre ke vrarë njerëzi!"/ Petrit Qoli kundërshton dëshminë e Nuredin Dumanit: Më çoni në gjjotinë nëse ky nxjerr një dëshmitar!
04 Mars, 2025

Erion Veliaj kundërshtoi arrestin me burg. Apeli i GJKKO-së cakton gjyqtarin Engert Pëllumbi për shqyrtimin e çështjes
04 Mars, 2025

"Mos hyr në familje se do iu bëj të qani", Nuredin Dumani përplaset me Agron Qolin në GJKKO: Mos më fol mua ashtu o legen!
04 Mars, 2025

KATEGORIA VIDEO

"S'mund të dalë emri i oficerit të BKH-së"/ Hajdarmataj debat me Sefën: Ç'problem ka? Po polici që arreston kriminelin?
04 Mars, 2025

"Tak Fak" në News24! Emisioni më i ri investigativ që do ndihmojë në zgjidhjen e shpejtë të problemeve të qytetarëve (VIDEO)
04 Mars, 2025

VIDEO/ Aston Villa feston në Champions, 3 gola dhe fitore ndaj Brugge në Belgjikë
04 Mars, 2025

Trashëgimia e Xhevahir Spahiut, nga kritika e mprehtë sociale te vrapi për drejtësinë
Fatmira Nikolli | 04 Mars, 2025

'Neranxi Group' merr pjesë në Panairin Horeca, Neranxi prezanton markat prestigjoze europiane të linjës Horeca'
04 Mars, 2025

Zgjedhjet e 11 majit/ Nga Meta te aleatët e tjerë, Stafa zbulon emrat e sigurt në listën e kryeqytetit: Tirana, një dhimbje koke për Berishën
04 Mars, 2025

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

"S'mund të dalë emri i oficerit të BKH-së"/ Hajdarmataj debat me Sefën: Ç'problem ka? Po polici që arreston kriminelin?
04 Mars, 2025

"Tak Fak" në News24! Emisioni më i ri investigativ që do ndihmojë në zgjidhjen e shpejtë të problemeve të qytetarëve (VIDEO)
04 Mars, 2025

VIDEO/ Aston Villa feston në Champions, 3 gola dhe fitore ndaj Brugge në Belgjikë
04 Mars, 2025

Trashëgimia e Xhevahir Spahiut, nga kritika e mprehtë sociale te vrapi për drejtësinë
Fatmira Nikolli | 04 Mars, 2025

'Neranxi Group' merr pjesë në Panairin Horeca, Neranxi prezanton markat prestigjoze europiane të linjës Horeca'
04 Mars, 2025

Zgjedhjet e 11 majit/ Nga Meta te aleatët e tjerë, Stafa zbulon emrat e sigurt në listën e kryeqytetit: Tirana, një dhimbje koke për Berishën
04 Mars, 2025

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2025 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.